



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
KËSHILLI GJYQËSOR I KOSOVËS
SUDSKI SAVET KOSOVA - KOSOVO JUDICIAL COUNCIL

Memorandum shpjegues për udhëzuesin nr. X/ 2024 për normën e punës së bashkëpunëtorëve profesional

<p>1. Qëllimi i hartimit të aktit normative</p>	<p>Udhëzuesi për Normën e punës së Bashkëpunëtorëve Profesional, synon të përcaktojë kriteret për normën e punës së bashkëpunëtorëve profesional të cilët punojnë në Gjykatat e Republikës së Kosovës, e cila ndërlidhet me normën e punës së gjyqtarit me të cilin punon, varësisht nga fusha dhe specifika e departamentit.</p> <p>Norma e punës së bashkëpunëtorit profesional vlerësohet duke u bazuar në sistemin e vlerësimit me pikë për secilën lëmi përfshirë edhe llojin dhe natyrën e lëndëve, varësisht nga fusha ku bashkëpunëtori është i caktuar të punoj.</p> <p>Duhet të theksohet se norma e punës së bashkëpunëtorëve profesional në Gjykatën Supreme të Kosovës, përcaktohet nga Kryetari i Gjykatës Supreme, pas konsultimit me kolegjet e gjyqtarëve brenda kësaj gjykate.</p>
---	--

2. Arsyetimi i aktit normative

Me qëllim të matjes së efikasitetit të punës së bashkëpunëtorëve profesional, është konsideruar si e nevojshme që të hartohet udhëzuesi për normën e bashkëpunëtorëve.

Ky draft është hartuar duke marrë për bazë edhe efektin e normës së gjyqtarëve, është analizuar Rregullorja Nr.03/2023 për Normën e punës së gjyqtarëve, në bazë të së cilës është përshtatë edhe struktura dhe pikësimi në këtë Udhëzues.

Kategorizimi i barabartë dhe gjithpërfshirës për të gjitha departamentet dhe divizionet, udhëzuesi përcakton dhe kategorizon llojet e lëndëve në grupe, është konsideruar i nevojshëm pasi që në këtë mënyrë do të vlerësohet ngarkesa e bashkëpunëtorëve.

Udhëzuesi përfshinë edhe pikët për secilin draftim të vendimeve të cilat bëhen nga ana e bashkëpunëtorëve profesional duke poentuar kështu secilin draftim të vendimeve të kryer në departamentet përkatëse si dhe për veprimet e tjera të cilat ndërrmarin bashkëpunëtorët gjatë punës së tyre.

3. Kohëzgjatja e konsultimit publik

Përmes procesit të konsultimeve me publikun, synohet transparenca dhe ofrohet mundësia e pjesëmarrjes së publikut dhe palëve të interesuara në procesin e hartimit të Udhëzuesit për Normën e Punës së Bashkëpunëtorëve Profesional.

	<p>Këshilli fton të gjithë profesionistët e interesuar që të paraqesin komentet apo sugjerimet e tyre, për përmirësimin e draftit të kësaj rregullore.</p> <p>Kohëzgjatja e konsultimit publik është pesëmbëdhjetë (15) ditë kalendarike, përkatësisht deri me 2 maj 2024.</p>
<p>4. Informatat në lidhje me personin kontaktues për konsultim publik</p>	<p>Të gjithë pjesëmarrësit e publikut dhe palët e interesuara mund t'i japin komentet dhe sugjerimet e tyre brenda afatit të përcaktuar për konsultim publik për këtë draft të rregullores përmes postës elektronike në këtë e-mail adresë: kgjk@rks-gov.net</p>